



EDUKIMI LETRAR DHE PROCESI KRIJUES I TALENTEVE TË REJA

(24 janar - 27 shkurt 2024)



Prishtinë
2024

Projekti është realizuar nga PEN Qendra e Kosovës

Përkrahur nga:



REPUBLIKA E KOSOVËS
MINISTRIA E KULTURËS, RINISË DHE SPORTIT

PARAFJALË

Projekti “Edukimi letrar dhe procesi krijues i talenteve të reja”, ka ofruar mundësinë e komunikimit me talentet e reja. Përvoja e shkrimtarëve, profesorëve, studiuesve, përkthyesve, publicistëve të cilët janë angazhuar në këtë projekt ka dëshmuar se për herë të parë në Kosovë është provuar një komunikim i tillë me gjenerata të reja, në radhë të parë, për të nxitur leximin si dhe për të frymëzuar dhe motivuar ata që të merren me krijimtari letrare.

Temat e trajtuara në këtë projekt kanë të bëjnë me fenomene dhe dukuri ndryshme letrare, kryesisht të ndërlidhura me procesin krijues, për të kuptuar më qartë e më saktë se si shkruhen shumica e zhanreve dhe llojeve të letërsisë: eseja, poezia, drama, tregimi, novela, romani, drama, studimi, fejtoni, reportazhi letrar, por edhe si përkthehen veprat letrare, si bëhet vlerësimi kritik i tyre, si botohen, si promovohen, cila është përparësia e zhvillimeve teknologjike, cili është roli dhe efekti i librit fizik etj.

Në fakt, qëllimi i këtij projekti është që të zbulohen sa më shumë talente të reja në shkolla, kolegje, fakultete të ndryshme të Kosovës, me qëllim që të përkrahen në

forma dhe mënyra të ndryshme për të botuar krijimtarinë e tyre.

Përmes shtrirjes së këtij projekti edhe në qytete të tjera të Kosovës do të synohet krijimi i rrjetit të talenteve të reja, të cilët në bashkëpunim me shkrimtarë me përvojë në Kosovë do kenë mundësi t'i realizojnë preokupimet e tyre krijuese me përkrahje nga PEN Qendra e Kosovës.

Shënim:

Në këtë botim përfshihen fragmente nga ligjëratat e mbajtura.



Ibrahim Kadriu

TË SHKRUARIT E FEJTONIT DHE REPORTAZHIT LETRAR

Gazetaria ka një shtrirje të gjerë përmes llojeve, të cilat janë të ndryshme, duke filluar nga lajmi, që është forma më e shkurtër e deri te fejtuni, që ka gjerësi dhe gjatësi përmbajtësore. Përmbajtjet e fejtoneve janë të ndryshme, varësisht nga interesimi i shkruesve, i atyre që paraprakisht bëjnë përgatitje për sigurimin e lëndës me të cilat do rrumbullakohet fejtuni si tërësi. Përmbajtjet me të cilat cilësohet fejtuni janë nga fusha të ndryshme: historike, kulturore, sociale, etnografike, etj. Përndryshe, fejtuni është një lloj shkrimi i gazetarisë, që gjithashtu mund të cilësohet si formë e gazetarisë letrare, meqë shkrimi i fejtunit realizohet me premisa letrare, pavarësisht temave që i shtron. Zakonisht fejtonet

botohen në gazeta, me ndarje teknike të vazhdimëve që mund të zgjasin me ditë, varësisht prej gjatësisë, ndërkaq temat shoqërohen me faktografi ekzistuese. Kjo domethënë se në fejtton shtrohen tema reale, qofshin ato aktuale, tema me përmbajtje interesante dhe, shpesh, ekskluzive; tema që iu interesojnë lexuesve, sepse në fejtone ofrohen fakte për ngjarje të ndodhura, por që në fejtone detajohen të dhënat për përfaqësim të realitetit.

Në fejtone gjejmë përmbajtje më interes si nga tematika, po ashtu edhe nga mbarshkrimi; tema që i kushtohen ndonjë ngjarje. Në hapësirën shkrimore të fejttonit gjejmë vend edhe portrete të ndryshme shkencëtarësh, shkrimtarësh, sportistësh dhe artistësh, pa kufizime të prezantimit të autoriteteve të ndryshme, por edhe të ngjarjeve të cilat e shënojnë kohën, siç janë ngjarjet e luftërave, etj. Prandaj, fejttoni prandaj e ka rëndësinë e vet të madhe, kurse shkrimin e fejtoneve e bëjnë profesionistët; njohësit e raporteve shoqërore, historike, shkencore, letrare dhe të fushave të tjera nga të cilat mund të nxirren përmbajtje interesante dhe të vlefshme për lexuesit.



Blerina Rogova Çaxha

MENDIMI MBI KUJTESËN LETRARE

Mendimi mbi kujtesën letrare të luftës ndërthur dallimin midis studimit të së ‘kaluarës traumatike’, të përfaqësimeve të luftës dhe dhunës në letërsi dhe njohurive të fundit për sa i takon transkulturalitetit të natyrshëm të kujtesës letrare dhe rrjedhës së studimeve letrare në të ardhmen.

Erll argumenton se “kujtesës i duhet të qarkullojë për të qëndruar gjallë”. Si qarkullon memoria dhe si ecin me ritmin e studimeve kulturore të memories edhe studimet e kujtesës letrare? Janë pyetjet të cilave teoricienët e ndryshëm të dijeve humane, përpiqen t’i japin përgjigje.

Vëmendja ndaj kujtimit të së kaluarës së afërt është përsheptuar nga luftërat dhe trazirat sociale e politike të viteve nëntëdhjetë. Shkrimtarët duket se i janë përgjigjur kësaj situatë në të paktën dy mënyra të ndërlidhura. Së pari, ata krijuan rrëfime letrare duke i kthyer në artefakte tmerret e së kaluarës së afërt, në mënyrë që të mos bien në harresë. Së dyti, shfaqja e luftës si një manifestim përcaktues i ndarjes radikale midis së shkuarës dhe së tashmes i detyroi autorët të reflektojnë mbi proceset e të kujtuarit dhe të harruarit në përgjithësi.

Kthimi drejt vetes në trajtën e kujtesës, është e pritshmja e letrave në një shoqëri të pasluftës. Memoria i kthehet realiteteve të një kohe tjetër, duke fituar kështu peshë poetike. Po, cila është memoria e luftës në veprën e autorëve që e kanë përjetuar luftën? Cila është dëshmia e tyre letrare, nëse dëshmitari moral, siç thekson Margalit “është ai që e përjeton vuajtjen – ai që nuk është vetëm një vëzhgues, por edhe një vuajtës” (2004: 150)? Kujtesa e viktimës e ka prodhuar letërsinë e traumës si një borxh personal apo si një lloj borxhi kolektiv, duke e shndërruar letërsinë në një mekanizëm të qëllimshëm të përzgjedhjes së dëshmimeve reale dhe imagjinare në histori dhe në jetë.

(KultPlus, 24 janar 2024)



Milazim Krasniqi

SI E SHKRUAJ DRAMËN?

Kureshtja ime e parë për dramën e teatrin ka filluar që nga klasa e dytë e shkollës fillore, kur e pashë një shfaqje në shkollë. Mësuesit që i njihja, madje dhe im vëlla që luante një rol episodik, aty ishin “tjetërkush.” Kush ishin ata në ato role? Aty e kuptova se ata quheshin aktorë, ndërsa ai që e kishte shkruar tekstin quhej dramaturg. Si nxënës i shkollës së mesme në Prishtinë, fillova të shkoja në teatër. Sa mbaj mend, shfaqja e parë që kam shikuar në ish Teatrin Popullor Krahinor, ka qenë drama “Perkolgjinajt”, me një peizash dramatik nga tradita. Më vonë si njëri nga burimet shtesë për të shkruar dramë ka qenë tradita shqiptare, me theks te historia po edhe te kënga kënga shqiptare. Në fakt, kënga shqiptare ka shumë dramë brenda vetes.

(Njërën prej tyre, këngën e Salih Sylës e kam përdorë për dramën “Besëpremja.” Natyrisht, me modifikime të mëdha.)

Dramën fillova ta shkruaja pas një përvoje të gjatë si poet e si studiues i letërsisë. Kjo është e natyrshme, ngase drama kërkon kulturë letrare, përvojë jetësore dhe energji për të shkruar. Për të shkruar dramë më janë dashur disa njohuri themelore teorike. I kam gjetur te Platoni, Aristoteli, Nikolla Boalo, Bertolt Brehti. Platoni gjithë artin e cilëson si imitim (mimesis.) Edhe drama e teatri janë imitime të realitetit jetësor. Bashkë me kulturën letrare, përvojën jetësore dhe energjinë për të shkruar, është i domosdoshëm edhe frymëimi. Nikolla Boalo (1636-1711) te “Arti Poetik” konstaton se pa frymëzim nuk ka art: “Kot në Parnas një poet guximtar/Lartësinë e vargënimit synon me e marrë/Burimi Qiellor nëse nuk e drejton/kur poeti lind, nëse Ylli, nuk e udhëzon.” Më vonë më ka pëlqyer më shumë qëndrimi teorik i Bertoltit Brehtit për teatrin në teatër dhe e kam aplikuar në komeditë “Kur lindi partia” e “Kush i bie fyellit” e më shumë në dramat “Monedha e Gentit” dhe “Rulet rus për Ali pashën.”



Dije Demiri Frangu

PSE SHKRUAJ?

Pse shkruaj?

Shkruaj se, kur trokasin kujtimet, unë u hapi derën si mikpritëse që më ka mësuar nëna të jem. Ato vinë si mike të vjetra të mira të çmallen, duke shtrirë gjithë fletat e shkruara, të grisurat e të pagrisurat, vinë edhe si armike të përbetuara ku vjellin ditët e hënta e netët e pagjumta.

Kujmet, kanë dëshirë të mbeten kujtime e të mos harrohen dhe vinë me urdhrin që t'i përjetësoj. Nuk shkruaj pra pse jam egoiste, shkruaj pra se jam zemërgjerë dhe i pranoj kërkesat e kujtimeve pavarësisht sa janë të egra e sa të buta. Nuk shkruaj pse jam egoiste, as pse dua të bëhem e pasur, as pse gjëja dua të jetoj pas vdekjes. Sa ironike kjo! Ato shkrime do të dilnin të zorit, të imponueshme dhe aspak shpirtërore.

Pse shkruaj?

Shkruaj, se nuk mund e harroj pamjen e detit kur shqetësohet e vlon e shkumëzon nga inati i dikujt, kur bie në depresion e as nuk pipëtinë, sa të duket një fytyrë e heshtur e një gjigandi të fjetur, për të mos thënë të vdekur. Atëherë kupton njeri se deti ka shpirt të madh, rebelues dhe unikal, një shpirt të kaltër e plot kripë, shpirt shtarë. Unë ia ndiej shpirtin dhe më dhimbset se më kap e më mban bukur, kur është i lumtur me diellin.

Pse shkruaj?

Shkruaj, se e kam lexuar Epin e Gilgameshit, vargjet në Bibël e pastaj Homerin, ata më kanë thënë shkruaj! Nuk shkruaj pse jam egoiste, pse dua të më njeh dikush, ai dikushi që mund të mos jetë askushi.

Shkruaj, se i dalloj ngjyrat e syve, ngjyrat e fushave dhe ngjyrat e pikave mbi krahë të fluturës, i dalloj zërat e gjetheve, zërat e ujërave, dhembjen e shkëmbinjve dhe heshtjen e gurit e di.

*(Biblioteka Komunale “Sadik Tafarshiku”
në Ferizaj, 29 janar 2024)*



Binak Kelmendi

SI I SHKROVA ROMANET?

Procesi i shkrimit letrar, sidomos ai i romanit, është një proces me kohëzgjatje te secili autor. Të paktën unë, i shtoj dhe i heq shumë gjëra. Nis një kapitull që mendoj se mund të jetë kapitull i parë dhe s'ka lidhje që ky mund të dalë kapitull i shtatë apo tetë ose krejtësisht ndonjë numër tjetër. Pastaj nis ta gdhend një personazh dhe ai shpesh bëhet kryepersonazh.

Çdo shkrim, sipas meje, është zbulim, akt krijues individual që, të paktën tek unë, embrionohet së pari në kokë.

Pastaj, pas zanafillës së shkrimit në mendje, pas bindjes se ai mund të realizohet me shndërrim në shkronja, autori, ose të them më mirë unë, edhe pasi ta kem bluar një kohë të gjatë idenë, temën, fillon luftën

krijuese me personazhet që do ta bëjnë ngjarjen, me dialogët që mund të ndryshojnë në momentin e fundit, me përshkrimet e ambienteve e të figurave etj. Dhe pastaj ulesh e shkruan.

Për shembull kështu e kam shkruar romanin tim të parë “Vezët e Vdekjes” botuar në vitin 2001. Romanin e kam filluar me fëmijërinë time e të moshatarëve të mi që ishte fëmijëri, do ta quaja e demonstrative, e kam vazhduar me luftën që filloi kundër pushtuesit serb dhe e kam përfunduar me dëbimin tonë, pse mos ta thërrasim holocaust, në vitin 1999.

Një histori krejt tjetër ka romani im pasues, “Guri i Vashës” që u botua në vitin 2012.

Guri i Vashës është një emërtim gjeografik që haset kudo nëpër viset shqiptare. Historia e toponimit të tij duket të jetë e lashtë sa edhe vetë Guri prej nga është hedhur vasha ose nusja shqiptare për ta shpëtuar nderin. Po kështu, kam vazhduar edhe me vepra të tjera...

Mendoj se letërsia, me temat e veta, krahas historisë me ngjarje e data e fakte, duhet ta shënojë epokën e një populli edhe kur ajo nuk është epokë e artë. Tani, vërtet, nuk kemi më asnjë nevojë për përdorim eufemizmesh as për veten tonë e lërë më për armikun shekullor siç e kemi pasur ne. Lavdërimi i historisë ndonjë herë është i mirë, ndoshta edhe frymëzues e motivues, por dehja me këtë lavdërim, siç ka ndodhur jo rrallë te ne, është dekurajuese dhe jo rrallëherë edhe shkatërrimtare.



Engjëll I. Berisha

BOTIMI DHE PROMOVIMI I VEPRËS LETRARE

Edhe pse po jetojmë në epokën e digjitalizimit, jetës virtuale apo elektronike, ku i nënshtrohen shumë nga proceset jetike, te libri ka një detyrim tjetër, ku nuk duhet lejuar tjetërsimit për nga vlera dhe standardi i botimit. Këtë duhet ta bëjnë së pari autorët, ta mbrojnë me fanatizëm, botuesit ti kenë parasysh standardet dhe profesionalizimin dhe institucionet mbështetëse, të kenë në konsideratë financimin dhe kontrollin me ligj.

Vlerat e publikimit të një libri janë esenciale për ta ruajtur kuptimin libër, pasi që e ndryshojnë, apo e mbrojnë gjendjen psikike e fizike të njeriut. Krijojnë apo ndërtojnë emocion, ide shkencore, e zhvillime me rëndësi për avancim të jetës.

Liberalizmi në gjuhën e shprehjes, edhe kur flasim edhe kur shkruajmë, lejon shprehje të lirë, por cila liri do të lejonte të shkatërrojë parafytyrimin për jetën, ekzistencën, idealin apo të vërtetën. Tani, botimi i lirë pa censurë e diferencime mundëson të dalin libra që s'mund ta kontrollojnë fuqinë e shprehjes. Shprehja ka peshën e një materie ndikuese, sikur e thonë kritikët letrarë “Artin original të shprehur nga krijuesi duhet ta kemi në libër letrar, që ta krijojë artin shpirtëror apo vizionin tek lexuesi”.

Libri përfaqëson edhe letërsinë, edhe shkencën, edhe ekonominë, edhe politikën edhe propagandën. Por, kur është libër, nuk lejohet t’iu dorëzohet klisheve “ditore” me humbë kuptimin e librit. Nëse politika po bie në empati nga shikuesi, kur kthehet në libër merr tjetër pamje, tjetër standard. Duhet ruajtur tërësinë e kuptimit të një libri, përmbajtjen, gjuhën, dhe mesazhin, pasi që ajo ruhet për vite e shekuj dhe pasqyron kohën kur është shkruar. Nëse nuk ka rëndësi edhe aq autori, e dëmton kohën dhe institucionin. Po kështu libri i nënshtrohet edhe gjitha temave tjera me kushtet që duhet të mbrohen nga shtëpitë botuese.

*(Biblioteka Komunale “Ibrahim Rugova”
në Gjakovë, 31 janar 2024)*



Anton Berishaj

VLERËSIMI KRITIK I LETËRSISË

Që nga fillet e mendimit sistematik për letërsinë është shtruar çështja e vlerës dhe e vlerësimit të saj (Platoni, Aristoteli...). Në shekullin XX, me konstituimin e dijes letrare sistematike dhe “autonome” – formalizmi, strukturalizmi, semiotika... – vlera estetike/letrare është parë si e domosdoshme dhe dominante, pra si vlerë intrinsike që e definon letërsinë si të tillë (forma, struktura, stili, narracioni, letrarësia...), edhe pse (posaçërisht te strukturalizmi kjo është vënë shpesh nën thjerrëzat e dyshimit teorik). Më anë tjetër, ndërkaq, posaçërisht te qasjet semiotike (Jan Mukarzhovski, Lotmani etj.) janë evidentuar edhe të ashtuquajturat vlera jashtestetike: vlerat e ekzistencës, vlerat intelektuale/kognitive, etike, sociale, religjioze, politike, ideologjike..., të cilat shpesh

si elemente strukturale të vetë veprave letrare janë parë të pashkëputshme nga vlera e tyre estetike/letrare, duke e theksuar vazhdimisht se në dimensionin e funksionit të tyre ato shpesh kanë qenë kusht i domosdoshëm që veprat e artit dhe të letërsisë të konsiderohen si të tilla. Ky dualizëm i vazhdueshëm epistemologjik, i cili projektohet edhe te dimensionin ontologjik i artit/letërsisë, është aktualizuar edhe në estetikën normativiste. P.sh. Gordon Graham konstaton se shpjegimi i vlerës së artit në këtë kontekst do duhej të kishte përparësi në relacion me përkufizimin se çfarë është arti (relacioni i artit me kënaqësinë, emocionet, njohjen...).



Gëzim Aliu

SI E SHKRUAJ ROMANIN?

Pse shkruaj? A mund të bëhet kjo pyetje?! Në disa periudha të jetës sime, kjo pyetje vjen sikur mjegull, jo e drejtpërdrejtë, nuk e lejoj të ma pengojë shikimin, pamjen, vizionin, përndryshe do të duhej ta lija të shkruarit. Kur e bëjnë të tjerët këtë pyetje, sikur kërkojnë përgjigje të saktë për diçka të qartë, të dukshme, të përdorshme, funksionale. Të shkruarit letrar, artistik, nuk është sikur të prodhuarit e një makine shërbyese, këtë besoj e di çdokush. Çfarë i shtynte njerëzit parahistorikë të vizatonin në shpella, të vendosnin shuplakat e tyre në shkëmb e të hidhnin ngjyrë?! Është dëshira, therja e brendshme për ta treguar praninë në jetë, therja e dëshira për të komunikuar me të tjerët edhe kur nuk i njej. Por, nuk është vetëm kjo therje, kjo dëshirë, është edhe përpjekja për ta ndërtuar veten, për ta zgjatur veten, për

të qenë emri dhe mbiemri që mbase do të lexohet edhe në të ardhmen. Pyetja ‘Pse shkruaj’ nuk ka përgjigje të saktë, po ashtu siç nuk ka përgjigje të saktë pyetja ‘Pse është jeta’. Do të mund të mos ishte e kurrë nuk do ta kishim marrë vesh.

Si shkruaj? Për këtë mund të flas shumë më saktë.

Për të nisur diçka më të madhe, është shumë e rëndësishme ideja. Ideja e ka një zanafillë, që do ta quaja shkëndijë. Nuk dua të mistifikoj këtu, por shkëndija krijimtare, që e quajnë edhe frymëzim, shpesh nuk dihet nga vjen, nga mendja, si nga qielli i kthjellët, nga dhembja që ndien për diçka, nga të dëgjuarit e një ngjarjeje, nga një ngjarje që sheh, nga leximi i diçkaje interesante, nga emocionet që shkakton diçka, nga qëllimet e vetëdijshme e nganjëherë të pavetëdijshme, nga bindjet, nga luhatjet e bindjeve, nga ndryshueshmëria e vazhdueshme njerëzore, që e quajmë përvojë, nga meditimi, nga të menduarit. Gjithçka mund të ndezë një shkëndijë dhe kjo shkëndijë mund të ndriçojë një ide, dhe këtë ide e shkruaj, gjithsesi duhet ta shkruaj, sepse mund të zhduket në errësirën e asgjësë shumë shpejt. Pas një kohë e shoh idenë e shkruar, që nganjëherë bëhet edhe skicë, shoqëruar ndonjëherë edhe me ndonjë vizatim. Idenë e mbjell në imagjinatë dhe nëse e shoh që ka kapacitet për t’u shndërruar në diçka më të madhe, tregim ose roman, vazhdoj të punoj.

*(Biblioteka Komunale e Prishtinës
“Hivzi Sulejmani”, 5 shkurt 2024)*



Lulzim Tafa

LETËRSIA PËRTEJ KUFIJVE

Te tregu i madh i librit, pra te letërsisë e kombeve të mëdha, letërsia gjithmonë ka qenë industri, tash është kuptuar edhe nga ne që vijmë nga letërsisë e kombeve të vogla. Mbase edhe jemi pajtuar me këtë fat, se krijojmë për një treg të ngushtë libri dhe më pak lexues se shkrimtarët e kombeve e sidomos të gjuhëve të mëdha.

Si gjithçka tjetër, edhe letërsia po evulon dhe këtë sa më herët që ta kuptojmë na bënë më mirë. Bela Balazh (eseist hungarez) ka parajmëruar apo ka parashikuar lindjen e një arti të ri edhe pse kuptohet se arti gjithmonë përcjell apo kultivon shijen e tij. Pra, ne prodhojmë apo shkruajmë për shijen e publikut dhe ajo po ndryshon. Sado e madhe dhe e vlefshme që të jetë

një krijimtari, megjithatë unë i qëndroj mendimit se ajo i takon një epoke së paku për nga rëndësia. Pas kalimit të asaj epoke ajo letërsi apo ai art mbetet i rëndësishëm gjithmonë, por vetëm sa i përket kontekstit kohor të cilit i ka shërbyer, pra shijeve të një kohe.

Për ta përfunduar këtë, letërsia sot si industri nuk funksionon fare pa logjistiken e saj, pa botuesit e fuqishëm, pa distribuimin, pastaj pa kritikët dhe pa promovuesit e saj, pa marketingun. Shkrimtari dhe libri kanë nevojë edhe për marketing. Një shkrimtar që, përveç talentit, i ka organizuar apo ka pasur fat edhe në këto shtylla, është shkrimtar që nuk mbijeton, por jeton dhe i shijon frytet e punës së vet, pse jo edhe ato materiale (....)

Poezia përcjell emocion, e emocionet tek askush nuk janë të njëjta e askush nuk i përjeton njëjtë. Pra, tiparet e të veçantat që sjell një poet nga një poet tjetër si stili, gjuha, narracioni që ndërton, mënyra si rrëfen, shkurtesat, zgjatesat, pastaj idetë, motivet, në përgjithësi bota poetike dhe, në fund të fundit, edhe vizualisht dukja e një poezie të shkruar dallon te poetët, pra edhe si formë. Të tëra këto e ndërtojnë individualitetin e një poeti. Pra këto, por jo vetëm, e përbëjnë individualitetin krijues që përcaktohen në forma dhe përmbajtje të ndryshme nga botëkuptimi i tij dhe që e dallojnë atë nga të tjerët.



Naime Beqiraj

LEXIMI DHE EDUKIMI LETRAR

Nga përvoja e mësimdhënëses, me durimin e pandalur kisha arritur që leximi të bëhet pjesë e lëndës, pjesë e vlerësimit, pjesë e notimit. Periudha e pandemisë ishte frytdhënëse; bashkë me të rinjtë porosisnim libra përmes postës nga librari e shtëpi botuese për t'i lexuar në ditët e mbyllura botërore që përjetuam. Kërkonin gjithsesi prozë. Autorë të preferuar kishin Kadare, Heminguej, Tolstoji, Markes, Hygo, aty këtu ndonjë vepër të Shekspir; disa i donin vargjet e “Lum Lumit”, kurse nga proza kosovare pak ose aspak, për poezi të mos flasim. Pra, ata para se të zgjidhnin librat për lexim, hulumtonin në internet sidomos për përmbajtjen e teksteve, numrin e faqeve.

Përvoja ime prej mësimdhënëse pas kësaj periudhe, rezultoi me lexime më sistematike nga ana e të rinjëve në kolegjin/universitetin ku punoja, kurse nxënësit e shkollës së mesme ishin më të pasionuar. Madje disa prej tyre, librat i kishin lexuar së bashku me prindërit, ndaj arritëm së bashku të mbillnim përkushtim për lexim letrar.

Pra, mund të lexohet, nevojitet të lexohet, kemi mundësi të lexohet. Të rinjtë e British School of Kosova lexojnë me pasion dhe kjo u reflektohet edhe në edukimin e përgjithshëm. Disa prej tyre të cilët sot i vazhdojnë studimet në universitete të njohura botërore shprehen mirënjohës se ç'rëndësi kishte pasur leximi për performancën e tyre jo vetëm në fushën e dijeve humane. Pra, së bashku e kuptuan që mund të jeshë jurist i mirë, inxhinier i mirë, por edhe lexues i mirë. Mund të jesh edhe mjek i mirë, por edhe lexues i mirë sepse shpirtin njerëzor, edukimin emocional e ndihmon leximi. Po, sepse kapaciteti analitik, psikologjik, kreativ, i oratorisë, ndjeshmërisë dhe kulturës janë më të fuqishme me leximin e librave të mire, prandaj nuk është i rastësishëm mesazhi i ndonjërit prej tyre: falemnderit profesoreshë për mundësinë dhe inkurajimin. Mesazhet e tyre ngrihen përtej një leximi të thjeshtë apo note më të lartë, mbetet edukimi artistik për të cilin kemi nevojë jo vetëm ne – raca e krijuesve dhe banorëve të letërsisë, por edhe përtej nesh. Fundja, letërsia krijohet për lexuesin.

(9 shkurt 2024, British School of Kosova)



Avni Spahiu

PROCESI I PËRKTHIMIT: SFIDAT DHE KËNAQËSITË

Procesi i përkthimit paraqet një komunikim artistik midis autorit, përkthyesit dhe lexuesit dhe fjalët e përdorura nga përkthyesi përbëjnë pjesën kryesore në procesin e komunikimit të ideve apo ndjenjave të autorit. Përkthyesi është ai që duhet të kuptojë, lexojë dhe interpretojë tekstin burimor i pari dhe ta përkthejë atë në një gjuhë dhe kulturë tjetër.

Mëtimi i përkthyesit është të japë një kontribut në procesin krijues duke ofruar një pjesë të kulturës nga gjuha e veprës që përkthen në gjuhën në të cilën përkthen dhe ky është, po ashtu “një bashkëdyzim” i përgjegjshëm ndaj asaj që njihet si krijimtari e botës letrare. Prandaj, përkthyesi letrar duhet të zotërojë

njohuri të mjaftueshme nga të dy gjuhët, atë bartëse dhe atë pranuese duke qenë në gjendje që të bart narracionin, stilin, disponimin, veçantitë krijuese dhe imagjinatën e autorit.

Pozicioni i përkthimit në komunikimin ndërkulturor është thelbësor. Qëllimi i përkthimit është transmetimi i ideve dhe ngjarjeve nëpër kohë dhe hapësirë për të kuptuar diçka, për të realizuar, për të vërtetuar. Bota që është gjithnjë e më e ndërlidhur, përmes përkthimit përmbush një rol duke thyer barrierat gjuhësore. Nga pikëpamja profesionale, përkthyesit luajnë një rol si ekspertë të komunikimit ndërkulturor, ndërmjetës dhe urë lidhëse ndërmjet njerëzve.

Siç thekson studiuesja amerikane Julia Thornton, “të jesh përkthyes do të thotë të heqësh një pengesë gjuhësore dhe, sa më shumë të jetë e mundur, të kalosh një hendek kulturor midis njerëzve. Do të thotë ta shohësh botën me sy të ndryshëm”. Përkthyesi është ai që përkthen gjuhën burimore në gjuhën e synuar. Gjuha është një gjallesë dhe referencat kulturore shtohen vazhdimisht me kalimin e kohës, kështu që përkthyesit duhet të përqafojnë kulturën e gjuhëve me të cilat merren dhe gjithashtu ngjarjet aktuale, pasi ato kanë një ndikim të madh në mënyrën se si njerëzit komunikojnë. Pra, përkthimi do të thotë se nuk është thjesht përcjellje e kuptimit nga një gjuhë në tjetrën, por është gjithashtu një krijim.



Sali Bashota

SI E SHKRUAJ POEZINË?

Fenomeni i frymëzimit, i trajtuar, fjala vjen, që nga Platoni në dialogun e tij me titullin “Ijoni ose mbi Iliadën”, ende nuk është shpjeguar përbrenda misterit të vet. Poezia krijon ambientin magjik, në radhë të parë, me funksionin e saj kuptimor, figurativ, stilistik, estetik.

Çdo poet synon ta ketë formulën e vet të ngjizjes dhe të harmonizimit të frymëzimeve, pra ta krijojë sistemin e vet të mendimit, i cili do ta karakterizonte individualitetin e tij krijues. Dua të them se poezia është ekzistenca e një bukurie të pashpjegueshme deri në fund, e cila synon ta përmbysë kohën e ankthit dhe të vuajtjes dhe ta fuqizojë kuptimin e saj të figurshëm dhe stilistik.

Gjërat e kësaj bote mund të perceptohen përbrenda peizazhit të vet dhe përfytyrimi nga koha e tashme synon të mbizotërojë edhe në kohën e ardhme.

Krijimi i një libri me poezi është ndërtimi i filozofisë së qindra apo mijëra ideve, ndjenjave, mendimeve, imazheve, situatave, figurave etj., të cilat grumbullohen përbrenda ligjërimit të poetit, në radhë të parë, për të formësuar botën e tyre, nga një perceptim i përditshëm i krijuesit në perceptimin e përjetshëm të lexuesve. Kështu mendoj unë, sepse poezia është një proces i përhershëm i udhëtimit të frymëzimeve në mendjen e poetit. Mjafton të ndizet një shkëndijë nga trupi i saj për të shpërthyer tërë ajo fshehtësi e ngujuar aty.

Procesi i të shkruarit është një akt solemn, që përbrenda shpirtit dhe mendjes e shtreson ballafaqimin e fuqishëm midis ndjenjave dhe mendimeve. Ndërtimi i ideve dhe konceptimi i imazheve, pra sistemimi i tyre në laboratorin e krijuesit është gjëja më misterioze. Përpiqem ta zbuloj përmbysjen dhe ringjalljen, por edhe shkëlqimin e imazheve të ngulitura në një hapësirë të meditimit, në një çast të harmonishëm që e kërkon ekzistencën e fjalës për ta shqiptuar pasionin për botën e frymëzimit. Çdo poezi ka filozofinë e vet të krijimit. Për më tepër, procesi i krijimit të një poezie mbase zgjat me javë të tëra apo edhe me muaj. Është një sprovë e dilemave dhe e anktheve, e shtresuar përbrenda motivimeve të autorit: si do të funksionalizohet gjuha, ligjërimi, figura, stili apo komunikimi e përjetimi gjatë dhe pas procesit të krijimit të poezisë.

(KultPlus, 12 shkurt 2024)



Osman Gashi

SI TË SHKRUASH ESE?

Të shkruash ese në nivel të kënaqshëm dhe paragrafë funksionalë, të qartë të përshtatshëm e domethënës për natyrën, llojin dhe synimin e esesë nuk është punë e lehtë. Ashtu si për të gjitha shprehjet edhe në këtë rast ky proces kërkon praktikë, organizim, përqendrim dhe përvojë.

Gjatë procesit të të shkruarit, shkruesi ndërton tekstin në një mënyrë të tillë që të ndikojë mbi lexuesin. Në këtë proces, shkruesi bën edhe parashikime për njohuritë e lexuesit, çfarë di dhe çfarë do të mësojë prej tekstit të tij.

Eseja është një formë letrare e cila përdoret për të shprehur qëndrimet, mendimet apo analizat e autorit për ndonjë temë të caktuar. Ky lloj shkrimi zakonisht i

kombinon elementet subjektive sikundër janë përvojat dhe ndjenjat personale krahas qasjes analitike dhe argumenteve. Eseja mund të hulumtojë një spektër të gjerë të temave – nga ato filozofike apo çështje sociale deri tek mendimet personale mbi situatat e përditshme.

Veçori thelbësore të esesë janë toni i autorit dhe liria e të shprehurit. Autori i esesë e shfrytëzon hapësirën për të shprehur zërin e tij të veçantë si dhe qëndrimin dhe stilin. Esetë shpesh shkruhen me një ton të drejtpërdrejtë, personal, ndërkaq shkrimtarit (shkruesit) i lejohet që të përdorë veten e parë. Po kështu eseja mund të përmbajë edhe elemente humori, ironie, apo madje elemente fantastike, varësisht nga stili i autorit.

Esetë shpesh nxiten të shkruhen në shkolla dhe universitete si mjet i vlerësimit të mjeshtërive analitike dhe kreative të studentëve, por po kështu mund të hasen edhe në shkrimet gazetareske, revistat letrare, apo në mediet tjera, në të cilat autorët duan të shprehin mendimet e tyre të veçanta për tema të caktuara.



Naim Kryeziu

ARTI I PËRKTHIMIT LETRAR

Përkthimi nënkupton transferimin ose bartjen e një tekst nga një gjuhë në një gjuhë tjetër. Përkthimi nuk ka të bëjë vetëm me bartjen e një teksti fjalë për fjalë – përkthimi ka të bëjë me ndërtimin e një ure gjuhësore, sepse gjatë procesit të përkthimit bëhet edhe bartja e kulturës dhe traditës të një pupulli. Krahasur me përkthimet e fushave të tjera, përkthimet e teksteve letrare janë shumë më të ndërlikuar. Një përkthim letrar i suksesshëm jo vetëm që duhet të riprodhojë kuptimin, por duhet të marrë edhe parasysh kulturën e gjuhës burimore dhe, në një masë të caktuar edhe frymën e gjuhës. Në këtë mënyrë, përkthyesi e pasuron gjuhën kombëtare, letërsinë dhe kulturën e vendit të vet. Këtu përfshihen në radhë të parë imazhet dhe idiomat

gjuhësore, por edhe veçoritë gramatikore të gjuhës përkatëse.

Një përkthim i suksesshëm letrar karakterizohet në radhë të parë nga fakti se ai e transferon një rrëfim saktësisht dhe me kuptim në një gjuhë tjetër. Ashtu si tregimi origjinal, një përkthim duhet të jetë i këndshëm dhe i rrjedhshëm për t'u lexuar dhe për të magjepsur lexuesin. Për të shmangur krijimin e një vepre krejtësisht të re, përkthimi duhet të jetë sa më afër origjinalit për nga kuptim dhe për nga përmbajtja, duke marrë gjithnjë parasysh karakteristikat dhe veçoritë e veçanta të gjuhës së synuar. Ndërsa, idiomat dhe shakatë në veçanti ndryshojnë nga njëra-tjetra në shumicën e gjuhëve, prandaj një përkthim fjalë për fjalë në të shumtën e rasteve nuk do të kishte efektin e dëshiruar të lexuesit. Përkthimi letrar karakterizohet nga përshtatja e kuptimit të tregimit me gjuhën e synuar dhe me kulturën e saj pa u larguar shumë nga teksti origjinal. Përkthimi i suksesshëm letrar është si të ecësh në litar. Nga njëra anë përkthyesi nuk duhet të përkthejë shumë fjalë për fjalë në mënyrë që të mos ndikohet gjallëria e tregimit. Nga ana tjetër, përkthyesi nuk duhet të largohet shumë nga teksti origjinal për të mos krijuar një tregim ose rrëfim krejtësisht të ri.

*(Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”,
Fakulteti i Filologjisë, 23 shkurt 2024)*



Ibrahim Berisha

KULTURA E KOMUNIKIMIT LETRAR

Një nga të mirat më të mëdha që krijoi njerëzimi, është shkrimi. Kultura e shkrimit është përmbajtje e qytetërimit. Edhe komunikimi si fenomen shoqëror dhe po kështu kulturor që ndjekë linjë të shumëllojshme të krijimi letrar.

Komunikimi letrar përveç informacionit që ofron me ide dhe mendim kreativ na bën që të ndihemi të lirë dhe të vetmuar. Shkrimtari i vetmuar ka një botë të veten të lirë, të pakufizuar në të cilën projekton botën dhe modelin e komunikimit estetik, krahas me veten edhe me lexuesin, herë më shumë me veten e herë më shumë me lexuesin.

Andaj arti është liri, shkrimi është liri. E kupton një ditë se mund të jetosh nga kjo liri, je pjesë e saj, krijues i saj, i formës dhe përmbajtjes së saj.

Cila mund të jetë arsye e përcaktimit të shkrimtarit për një zhanër letrar? A ka ndonjë arsye ta dijë këtë shkrimtari, kur nuk e kërkon fare ta dijë, po këtë, lexuesi? Mbase është kjo një marrëveshje paqeje, ndërmjet shkrimtarit dhe lexuesit, e cila ofrohet si dhunti kulture, ndjeshmërie dhe racionale?

Zhanret letrare bashkëjetojnë, këmbehen, transformohen, marrin e japin, në një mikrokosmos të shkrimtarit. Më mirë thënë në një mikrokaos të shkrimtarit: risi, publicistikë, poezi, prozë, dramë, mendim, dijë, shkenca. E gjitha, art, pra.

Do t'i referohesha Orëll-it, se shpesh zhanret e komunikimit letrar diktohen nga standardet kulturore, nisur që nga egoizmi e deri te qëllimet politike. Por është e kuptueshme se entuziazmi estetik, si dhe vëzhgimi nga brenda i bukurisë së botës së jashtme, mund të jenë një nga arsyet që kemi kaq shumë dashuri për komunikimin letrar, leximin. Duke mos iu ndarë këtij komunikimi, edhe mund të kemi një botë më njerëzore, me të dashur dhe më të pazhurshme. Më të qytetëruar.



Artan Krasniqi

PREZANTIMI I LIBRIT NË MEDIET ELEKTRONIKE

Raporti i teknologjisë me dijen sot në përgjithësi, e me librin në veçanti është i shumanshëm. Diskutimi këtu prek vetëm dy aspekte të këtij relacioni, konkretisht mbi raportin e shoqërisë sonë me librin elektronik, si dhe rolin e medias në promovimin e librit.

Fillimisht duhet theksuar se E-libër apo libër elektronik konsiderohet një skedar dixhital që përmban një pjesë teksti dhe imazhesh të përshtatshme për t'u shpërndarë në mënyrë elektronike dhe për t'u shfaqur në ekran në një mënyrë të ngjashme me një libër të printuar. Industria për blerjen dhe shitjen e librave elektronikë u shfaq fillimisht si një biznes i zakonshëm në fund të viteve 1990, kur kompani si Peanut Press filluan të shesin përmbajtje librash për lexim në

Asistencë Dixhitale Personale (PDA), pajisje dore që ishin paraardhësit e telefonave të mençur dhe tabletëve të sotëm. Një ringjallje e kësaj industrie ka filluar kur Korporata Sony lëshoi një pajisje leximi elektronik në 2006 dhe Amazon.com lëshoi Kindle në 2007, pas së cilës shitjet e librave elektronikë në Shtetet e Bashkuara u rritën me shpejtësi.

Kur flitet për librin elektronik në Kosovë, parë edhe në një kontekst të të dhënave empirike, ka një paradoks. Një hulumtim i kryer nga SHB “Dukagjini” dhe ETEA (2023), ka nxjerr se “grupmosha që preferon më shumë leximin në Kosovë është ajo 15-19, ndërsa ajo që preferon më pak leximin është 50-64 vjeç”. Në anën tjetër, sipas ASK-së, shpërndarja e internetit në Kosovë është pothuajse 100 për qind, dhe natyrisht përdorimin më të madh e gjen tek të rinjtë. Por nga hulumtimi i lartcituat bëhet me dije se vetëm 6.5 për qind e të anketuarve (rreth 1500 respondentë) kanë thënë se preferojnë të lexojnë libra elektronikë.

Ndërkaq mediet e reja, përfshirë edhe rrjetet sociale mbesin mundësi e mirë për të targetuar publikun e interesuar për librin, krahas potencialit të madh që e ka për të shtuar atë. Përtej kësaj, ndonëse ka shkaktuar hipërprodhim, pikërisht këto rrjete sociale, mund të jenë hapësirë që talentet e reja mund ta shfrytëzojnë për të krijuar publikun e tyre të parë në rrugëtimin e tyre artistik.

*(Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”,
Fakulteti Filozofik, 27 shkurt 2024)*

PËRMBAJTJA:

Parafjalë	3
Ibrahim Kadriu TË SHKRUARIT E FEJTONIT DHE REPORTAZHIT LETRAR	5
Blerina Rogova Gaxha MENDIMI MBI KUJTESËN LETRARE	7
Milazim Krasniqi SI E SHKRUAJ DRAMËN?	9
Dije Demiri Frangu PSE SHKRUAJ?	11
Binak Kelmendi SI I SHKROVA ROMANET?	13
Engjëll I. Berisha BOTIMI DHE PROMOVIMI I VEPRËS LETRARE	15
Anton Berishaj VLERËSIMI KRITIK I LETËRSISË.....	17
Gëzim Aliu SI E SHKRUAJ ROMANIN?.....	19

EDUKIMI LETRAR DHE PROCESI KRIJUES I TALENTEVE TË REJA

Lulzim Tafa	
LETËRSIA PËRTEJ KUFIJVE	21
Naime Beqiraj	
LEXIMI DHE EDUKIMI LETRAR	23
Avni Spahiu	
PROCESI I PËRKTHIMIT: SFIDAT	
DHE KËNAQËSITË	25
Sali Bashota	
SI E SHKRUAJ POEZINË?	27
Osman Gashi	
SI TË SHKRUASH ESE?	29
Naim Kryeziu	
ARTI I PËRKTHIMIT LETRAR	31
Ibrahim Berisha.....	
KULTURA E KOMUNIKIMIT LETRAR	33
Artan Krasniqi	
PREZANTIMI I LIBRIT NË MEDIET	
ELEKTRONIKE.....	35